



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.866/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakoves Shpejtim Mulaj nga Subjekti Politik IRDK, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Gjakoves paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.866/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakoves, Shpejtim Mulaj nga Subjekti Politik IRDK, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Gjakoves për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakoves Shpejtim Mulaj me të cilën pretendon se të njejtit i mungojne votat dhe se sipas rezultatit të KQZ-se ka marre vetem 21 vota i njejtë pretendon se sipas rrethit të tijë familjar ka me shume persona te cilet e kane votuar dhe se dyshon se votat e tijë kane humbur dhe kerkon rinumrim te votave në vendvotimet 0214C/01R,0214C/03R,0214C/04R 2605D/05D,

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakoves, Shpejtim Mulaj, brenda afatit ligjor ka parashtruar apelin ku ka kërkuar nga PZAP-i, që te bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimet 0214C/01R,0214C/03R, 0214C/04R,0229C/01R.në komunën e Gjakoves.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në

rastin konkret, Paneli verifikoi provat e ofruara si dëshmi nga apeluesi që ishin Formularët e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve nga të cilat formularë rezultoi se kandidati për anëtarë të Kuvend Komunal në Komunën e Gjakoves Shpejtim Mulaj nga radhët e Subjektit Politik IRDK, në vendvotimet e pretenduara si në apel kishte gjithsej 21 vota e jo me shume vota ashtu siç edhe pretendon në apel. Ndër të tjera nga rezultatet zyrtare të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve rezulton se apeluesi në këto vendvotime të pretenduara si në apel ka gjithsej 21 vota.

Paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, Paneli pasi verifikoi listat e vendvotimeve të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) konstatoi se vendvotimi i pretenduar si në apel 0214C/01R,0214C/03R,0214C/04r,0229C/01R.Me këtë numër nuk ekziston në asnjë qendër të votimeve të Kosovës, andaj edhe si të tillë e refuzoi si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.866/2021 më datën 06.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.